

HULIGANIZMI(BULLYING) DHE NGACMIMI (HARASSMENT)

ÇFARË DUHET TË DINË PRINDËRIT DHE KUJDESTARËT

➤ LE TË PËRCAKTOJMË TEMËN QË DO TË TRAJTOJMË.

ÇFARË ESHTË HULIGANIZMI(BULLYING)? Jo çdo konflikt është huliganizëm (bullying). Bullying është sjella e ashpër, e vazhdueshme, ose e papëlqyer, e cila ndërhyr në edukimin e fëmijës, ose në mjedisin e shkollës. Huligan (Bullying) është një person i cili vazhdimisht abuzon me fuqinë e tij ndaj një personi tjetër.

ÇFARË ESHTË NGACMIMI (HARASSMENT)? Ngacmimi është një sjellje e papëlqyeshme verbale, me shkrim, me grafikë, ose fizike, e cila lidhet me gjininë, moshën, racën, ngjyrën, orientimin seksual, shprehjen e identitetit gjinor, origjinës kombëtare, besimit fetar, paaftësisë, aftësisë të të folurit Anglisht, statusit social-ekonomik, ose bindjeve politike të një personi tjetër.

➤ ÇFARË DUHET TË BEJNË PRINDËRIT DHE KUJDESTARËT?

THUAJINI FËMIJËVE TUAJ, që huliganizmi dhe ngacmimi (bullying and harassment), janë të ndaluara. Është krejtësisht e gabuar; ata nuk duhet të sillen në këtë mënyrë, dhe në rast se kjo ndodh tek ata nga persona të tjerë, ata duhet ta denoncojnë menjëherë te ju dhe mësuesi i tyre.

SHËMBUJT janë mënyra më e mirë që fëmijët të mësojnë atë që ju keni ndërmend. P.sh, tallja, ose kërcënimi ndaj një personi për shkak të racës, gjuhës së tij amtare, ose orientimit të tij seksual, nuk është e drejtë-Kjo është ngacmim (harassment)! Kërcënimi i dikujt nëpërmjet internetit është cyberbullying!

➤ NËSE DYSHONI SE FËMIJA JUAJ ËSHTË KEQTRAJTUAR, OSE NGACMUAR, ju duhet të:

RAPORTONI situatën te mësuesi i fëmijës tuaj dhe/ose administratori i shkollës. Pyeteni fëmijën tuaj: kush ishte i përfshirë, çfarë bënë ata, ku dhe kur ndodhi kjo. Plotësoni formularin e Drejtorisë Arsimore për Raportin e sjelljeve Huligane dhe Ngacmimit (Bullying and Harassment Reporting and Investigation Form) (gjendet në shkollë dhe në uebsajtin e Drejtorisë: <http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/l/language-albanian/-allegation-of-bullying>) Në rast se kërkon shërbime përkthimi për plotësimin e raportit, pyesni shkollën. Në rast se përgjigja do të mungojë, telefononi linjën e hapur të Drejtorisë për këtë qëllim (215) 400-SAFE.

I OFRONI fëmijës tuaj strategji pozitive, si p.sh pyetni mësuesin për ndihmë, kërkon takim me këshilltarin dhe shfaqjen e huliganizmit.

Si do të vepronin në rast **SE NUK** funksionon? E inkurajoni fëmijën të mbrohet. E inkurajoni që ta injorojë sjelljen e tillë. Drejtoheni te fëmija që manifeston sjellje të tilla.

➤ ÇFARË DUHET TË PRISNI NGA KJO?

Shkolla duhet të kryej një hetim të plotë për ngjarjen, për të mësuar nëse konflikti është sjellje rrugaçerore (bullying), ngacmim (harassment), ose sjellje të tjera që duhen trajtuar. Ju duhet të informoheni për rezultatet e hetimit dhe hapat që do të ndërmarrë shkolla në vazhdim. Megjithatë, ligji federal i ruajtjes të informacionit të jetës private të tjetrit e ndalon dhënien e informacionit që lidhet me masat disiplinore, ose ndërhyrjeve ndaj një nxënësi tjetër.

➤ PYETJE?

Flisni me mësuesin dhe drejtorin e fëmijës tuaj. Frekuentoni takimet e prindit gjatë vitit shkollor ku diskutohen çështje të tilla. Telefononi ose dërgoni email te Nëpunësi i Drejtorisë që trajton problemet e Sjelljeve Rruçaçerore dhe Ngacmimit (Bullying dhe Harassment): **Diane Bernoff Sher**, Esquire në telefon; 215-400-5610, email; dbsher@philasd.org.